

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Telekom Serbia, shoqëri aksionare Beograd, Serbi do të fitoj kontrollin mbi GLOBALTEL SHPK Beograd, Serbi**

**(lënda nr. 08-70/2023)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 28.04.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilën Shoqëria për Telekomunikacion Telekom Serbia, shoqëri aksionare Beograd, me seli në Takovska nr.2 Beograd Serbi, synon të fitoj kontrollin mbi GLOBALTEL SHPK Beograd, Serbi me seli në rrugën 24 Mekenzijska, kati 1, Beograd-Vračar, Serbi.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

Shoqëria aksionare Telekom Serbia Beograd është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimit elektronik, i regjistruar për telekomunikacion kabllor, i cili gjithashtu ofron shërbime të telefonisë fikse dhe mobile, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Telekom Serbia ka një subjekt të lidhur, përkatësisht Shoqërinë për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJ Shkup me seli në rr. Maksim Gorki 11/1-3 Shkup i regjistruar për veprimtarinë e komunikimeve me tela, d.m.th ofron shërbime të rrjetit publik - komunikues, qasje në internet me brez të gjerë, shërbime ndër-operatoresh, shërbime telefonike të disponueshme për publikun në rrjet publik të komunikimit celular, ritransmetim të shërbimeve programore televizive, satelitore.

GLOBALTEL SHPK Beograd është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimit elektronik, i notifikuar si operator celular virtual.

GLOBALTEL SHPK Beograd nuk realizon të ardhura nga shitjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka shoqëri të regjistruara të lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se tregu përkatës, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit, mund të përkufizohet si treg për ofrimin e shërbimeve të telefonisë celulare.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

05.05. 2023

Shkup